



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 8821/Prot.

Tiranë, më 05.12.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1496/3, datë 20.11.2014.

SHOQËRISË “BALKAN MINERAL INVEST” SH.P.K

Rruga "Ismail Qemali", Pall. 7/1, Shk. 2, Ap. 10, Tiranë

**Për dijani: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Balkan Mineral Invest” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1496/3, datë 20.11.2014, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin “Treblovë, Romes”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.4715, datë 14.11.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3821, Prot, datë 16.11.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1496/3, datë 20.11.2014, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin “Treblovë, Romes”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minierar ku nga kontrolli në objekt u konstatua se subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minierar për më shumë se 180 ditë dhe për dy vjet rradhazi zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit ka dështuar në realizimin e 90% të vlerës së investimit, të parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “b” (ii) dhe pika 1, gërma “f” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1496/3, datë 20.11.2014, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin “Treblovë, Romes”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1496/3, datë 20.11.2014, për mineralin rërë bituminoze, në Objektivin "Treblovë, Romes", Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10/304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BAILLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

